



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.84

2004

22 nëntor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.723, datë 5.11.2004	Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit.....	6237
Vendim i KM nr.724, datë 5.11.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.198, datë 4.5.1993 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave”, të ndryshuar.....	6239
Vendim i KM nr.725, datë 5.11.2004	Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.....	6240
Vendim i KM nr.734, datë 5.11.2004	Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejes së përpunimit të nënprodukteve të naftës.....	6240
Vendim i KM nr.735, datë 5.11.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	6242
Vendim i KM nr.748, datë 11.11.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar”.....	6243

Vendim i KM nr.750, datë 11.11.2004	Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, për rikonstruksionin e urës së Rrjollit në Shkodër	6243
Vendim i KM nr.752, datë 11.11.2004	Për shpalljen “Ansambël historik” dhe “Zonë e stimuluar” të Pallatit të Brigadave dhe të parkut të tij.....	6244
Vendim i GJK nr.15, datë 10.11.2004	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.32, datë 4.3.2003 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.308, datë 6.6.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nenit 131/f, 31/ç e d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 27 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si antikushtetuese	6245
Vendim i GJK nr.16, datë 11.11.2004	Me objekt shfuqizimin e nenit 34 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si të papajtueshëm me Kushtetutën.....	6248
	Shpallje kërkesë për shpronësim me objekt shpronësimin me interes të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore”, që preken nga ndërtimi i linjës elektrike “Për lidhjen e nënstacionit elektrik 220/110 kv Rrashbull me sistemin”	6256
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Asllan Hasan Tresa..	6257

VENDIM
Nr.723, datë 5.11.2004

**PËR PROCEDURAT DHE RREGULLAT BAZË TË FUNKSIONIMIT TË ORGANIZMIT TË
AUTORIZUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “b” e “c” të nenit 10 të ligjit nr.9097, datë 3.7.2003 “Për vlerësimin e konformitetit”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlerësimi i konformitetit kryhet nga organizmi i autorizuar, në përputhje me procedurat e mëposhtme:

- a) marrja e mostrës, sipas standardeve përkatëse në fuqi, dhe paraqitja e produktit për ekzaminimin e tipit;
- b) kryerja e provave sipas metodikave të standardizuara;
- c) inspektimi, vlerësimi, verifikimi dhe certifikimi i produktit, në bazë të rezultateve të provave.

2. Prodhuesi i produktit dhe/ose importuesi i lëndëve të para, për të kryer vlerësimin e konformitetit, duhet t'i paraqesë organizmit të autorizuar të dhënat për identitetin e subjektit, vendin e prodhimit të produktit dhe dokumentacionin teknik, i cili përmban:

- a) përshkrimin e përgjithshëm të produktit;
- b) vizatimet e produktit, skemën e konstruksionit, pjesët përbërëse, përbërjen e produktit, procesin teknologjik, mbrojtjen nga zjarri, karakteristikat kimike, fizike e biologjike për mbrojtjen e shëndetit të njeriut e të kafshëve dhe për mbrojtjen e mjedisit natyror;
- c) përshkrimin dhe sqarimet e domosdoshme për leximin e vizatimeve, të skemave, instruksionet për përdorim, përfshirë edhe kërkesat e shërbimit dhe shënimet për karakteristikat e mbrojtjes nga zjarri;
- ç) paralajmërimet për rreziqet dhe instruksionet për sigurinë e përdorimit, të shkruara qartë dhe në vend të dukshëm në produkt ose në ambalazhin e tij;
- d) standardin ose rregullin teknik, të cilit i referohet prodhimi i produktit;
- e) përfundimet e llogaritjeve dhe të analizave;
- ë) protokollat e kontrollit dhe certifikatat.

3. Deklarimi i konformitetit të produktit me kërkesat teknike dëshmohet nga deklarata e konformitetit, e cila përmban:

- a) emrin dhe adresën e prodhuesit ose të të autorizuarit prej tij;
- b) përshkrimin e produktit (tipin, identifikimin, përdorimin);
- c) kërkesat teknike, me të cilat produkti është në konformitet;
- ç) kushtet e veçanta, të vlefshme për përdorimin e produktit;
- d) organizmin e autorizuar, që ka kryer vlerësimin e konformitetit.

4. Hedhja në treg e produktit të sferës së detyruar bëhet pasi të jetë kryer vlerësimi i konformitetit, që vërtetohet me inicialet SL (sipas ligjit), të vendosura nga prodhuesi mbi produkt, pas deklarimit të konformitetit, në përputhje me kërkesat teknike, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit regjistron dhe depoziton SL-në në Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

6. Nëse ka ndryshime nga deklarimi i konformitetit të produktit ndaj kërkesave themelore të tij, atëherë duhet bërë deklarim i ri konformiteti, duke përfshirë në deklaratë edhe shtesat përkatëse.

7. Subjektet që i hedhin produktet në treg, kanë detyrë ta ruajnë dokumentacionin teknik për të paktën 10 vjet nga data e prodhimit të fundit ose për një periudhë tjetër, nëse është specifikuar ndryshe në kërkesat teknike.

8. Për t'u miratuar nga Këshilli i Ministrave, organizmi që kërkon të kryejë vlerësimin e konformitetit, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse një kërkesë me shkrim, si dhe të plotësojë kushtet e kriteret e mëposhtme:

a) Të jetë i regjistruar në gjykatë si person fizik a juridik. Kur organizmi i interesuar është institucion publik, duhet të paraqesë aktin e krijimit të tij;

b) Të jetë i pajisur me certifikatën e akreditimit, për fushën përkatëse, ku do të kryejë vlerësimin e konformitetit, të lëshuar nga Drejtoria e Akreditimit;

c) Të ketë specialistë me arsim të lartë, të pajisur me dëshmitë përkatëse, në fushën ku kërkon të kryejë vlerësimin e konformitetit;

ç) Të deklarojë se nuk ka konflikt interesash në fushën ku kërkon të kryejë vlerësimin e konformitetit;

d) Të paraqesë dokumentin bankar, për të vërtetuar se ka burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e kësaj veprimtarie.

9. Kërkesa shqyrtohet nga ministri përgjegjës, sipas fushës së veprimtarisë që mbulon, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës me shkrim, dhe dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave.

Kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi, kërkesa refuzohet me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit ose sugjerimet përkatëse, për plotësimin e mangësive.

10. Pas miratimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit, ministri përgjegjës apo institucioni qendror lëshon autorizimin përkatës, për një afat 3-vjeçar, me të drejtë rinovimi.

Autorizimi përmban:

a) emërtimin e organizmit dhe adresën;

b) datën e miratimit të kërkesës, e cila është edhe data e fillimit të afatit të autorizimit;

c) objektet e veprimtarisë në fushën konkrete të vlerësimit të konformitetit.

11. Autorizimi pezullohet nga ministri përgjegjës apo institucioni qendror, për një afat 3 deri 6-mujor, në rastet kur organizmi i autorizuar shkel kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë vendim. Në rast se shkeljet nuk rregullohen brenda afatit të caktuar, ministri përgjegjës i propozon Këshillit të Ministrave shfuqizimin e vendimit, që ka miratuar organizmin e autorizuar.

Për çdo dhënie, pezullim apo ndryshim në autorizim, dërgohet njoftim me shkrim në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, e cila mban një regjistër për të gjitha të dhënat e shënuara në autorizimin përkatës.

12. Organizmi i autorizuar, brenda natës 30 janar të çdo viti, paraqet, për çdo veprimtari të kryer, të dhëna ose një raport pranë ministrisë apo institucionit qendror përkatës.

13. Të gjitha shpenzimet e organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit të përballohen nga prodhuesi i produktit apo importuesi i lëndëve të para.

14. Organizmi përkatës i autorizuar, kur vëren se prodhimi i produktit nuk është në konformitet me kërkesat teknike, njofton ministrinë përkatëse dhe organin përgjegjës për marrjen e masave në mbrojtje të konsumatorit, në përputhje me ligjin nr.9135, datë 11.9.2003 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

15. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.724, datë 5.11.2004

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.198, DATË 4.5.1993 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.198, datë 4.5.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Paragrafi i dytë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Objekt i veprimtarisë së Entit Kombëtar të Banesave është financimi, ndërtimi dhe shitja e banesave në kushtet e konkurrencës së lirë, për sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për vazhdimin e veprimtarisë, për mbështetjen e politikave sociale të strehimit dhe për sigurimin e banesave me kosto të ulët, në përputhje me ligjin nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet e strehimit të banorëve të zonave urbane”.”

2. Shkronja “f” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“f. Blerje trojesh nga subjekte publike apo private, për ndërtimin e banesave të paracaktuara për t’u shitur në tregun e lirë.”.

3. Pas shkronjës “h” të pikës 2, shtohen shkronjat “i”, “j”, dhe “k”, me këtë përmbajtje:

“i. Hyn në marrëveshje bashkëpunimi me subjekte publike apo private për realizimin e projekteve me interes të përbashkët.

j. Ndërton banesa me kosto të ulët dhe i shet ato me kredi, me kushte lehtësuese, për familjet, që kanë nevojë për strehim, sipas përcaktimeve të bëra në aktet ligjore në fuqi.

k. Në rastet kur, sipas lejes së dhënë nga organet përkatëse, parashikohet ndërtimi i mjediseve për zyra ose shërbime, në katet e para të objekteve të banimit kryen shitjen e tyre në tregun e lirë.”.

4. Pas paragrafit të katërt të pikës 3, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Këshilli drejtues, përveç kompetencave të njohura nga ligji nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, dhe ato të përcaktuara në statutin e tij, ka edhe këto kompetenca:

a) I propozon Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit kandidaturën e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Entit Kombëtar të Banesave;

b) Miraton marrëveshjet sipas shkronjës “i” të pikës 2 të vendimit;

c) Miraton përdorimin e të ardhurave të siguruara nga veprimtaria e Entit Kombëtar të Banesave në tregun e lirë, për programet sociale të banesave me kosto të ulët, sipas akteve ligjore në fuqi dhe në bazë të analizave ekonomiko-financiare të hartuara nga ky ent;

ç) Miraton kriteret e përcaktimit të punonjësve, që përfitojnë strehim, nëpërmjet të ardhurave të Entit Kombëtar të Banesave, në njërën nga format e mëposhtme:

- kredi për strehim;

- shitje të pronës me rezervë për blerje banese nga tregu;

- banesë me vlerën e kostos, në objektet e banimit, që ndërton Enti Kombëtar i Banesave, për t’i shitur në tregun e lirë.”.

5. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.725, datë 5.11.2004

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2004, MIRATUAR PËR MINISTRINË E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i shtohet fondi prej 8 000 000 (tetë milionë) lekësh, për Teatrin Kombëtar të Operas dhe të Baletit, i ndarë përkatësisht:

a) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, në zërin “Projekte kulturore”;

b) 1 000 000 (një milion) lekë, në zërin “Shpenzime operative”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.734, datë 5.11.2004

PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJES SË PËRPUNIMIT TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12.1, 17 e 18.1 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Leja e përpunimit

1. Veprimtaria e përpunimit të nënprodukteve të naftës kryhet nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqërive anonime, pasi të jenë pajisur me lejen e përpunimit, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

2. Leja e përpunimit u jepet shoqërive që kanë si objekt të veprimtarisë përpunimin e nënprodukteve dhe të gjysmëprodukteve të naftës dhe të gazit dhe që kanë në pronësi ose në përdorim impiante teknologjike përpunimi, për prodhimin e produkteve të reja hidrokarbure, si vajra të ndryshme lubrifikante, përzierje nënproduktesh të naftës, të ambalazuara në enë jorimbushëse, të gatshme për konsumatorët.

II. Procedurat për dhënien e lejes së përpunimit

1. Për dhënien e lejes së përpunimit, subjekti duhet të paraqesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Hidrokarbureve këto dokumente:

a) Kërkesën, ku të shënojë llojin e veprimtarisë që do të zhvillojë dhe llojin e nënprodukteve që do të prodhojë;

b) Vendimin e gjykatës për regjistrimin e personit juridik;

c) Certifikatën e regjistrimit në zyrën e tatimeve dhe NIPT-in;

ç) Vërtetimin e pronësisë ose kontratën e qirasë, për një periudhë të barabartë me vlefshmërinë e lejes së përpunimit, për impiantin e përpunimit e magazinën që do të përdorë dhe lejen e shfrytëzimit, të lëshuar nga zyra e urbanistikës së njësisë së qeverisjes vendore;

d) Projektin teknologjik të impiantit, të miratuar nga organet e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe lejen mjedisore të miratuar nga Ministria e Mjedisit. Për impiante që përpunojnë gazin e lëngëzuar të naftës, projekti teknologjik të jetë i miratuar dhe nga organet e kontrollit të pajisjeve nën presion;

dh) Vërtetimin e lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës dhe të Gazit, për respektimin e normave dhe të kushteve teknike;

e) Planbiznesin për veprimtarinë që do të realizojë shoqëria;

ë) Kontratën e punësimit të drejtuesit teknik, së bashku me dokumentacionin dhe vërtetimin e formimit profesional të tij;

f) Vërtetimin e pronësisë apo kontratën e qirasë/marrjes në përdorim, për një periudhë të barabartë me vlefshmërinë e lejes së përpunimit, për mjetin transportues të produkteve.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve ushtron kontroll për të verifikuar vërtetësinë e të dhënave dhe të treguesve të paraqitur në dokumentacionin e subjektit kërkuar.

3. Nëse dokumentet janë të plota dhe të rregullta, ministri përkatës jep lejen e përpunimit të nënprodukteve të naftës.

4. Afati për ushtrimin e kontrollit dhe afati i dhënies së lejes nuk mund të jenë më shumë se 30 ditë nga data e mbërritjes së kërkesës të subjektit.

5. Kur nga vërtetimi i të dhënave dhe i treguesve rezulton se nuk plotësohen kushtet e kërkuara, dokumentet e paraqitura i kthehen subjektit, i cili mund t'i riparaqesë ato pas plotësimit.

6. Kur pas afatit prej 30 ditësh nga çasti i depozitimit të kërkesës, subjektit nuk i është kthyer përgjigje, ai ka të drejtë të ankohet në përputhje me ligjin "Për procedurat administrative".

7. Subjekti që e ka ngritur veprimtarinë prodhuese, por nuk është i pajisur me këtë leje përpunimi, pajiset me këtë leje brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Leja e përpunimit përmban:

a) numrin dhe datën e lëshimit;

b) emrin dhe selinë e subjektit;

c) objektin e veprimtarisë, referuar llojit të produkteve të naftës ose gazit që do të hedhë në treg;

ç) afatin e vlefshmërisë;

d) vendndodhjen e impiantit.

dh) llojin dhe afatin e dokumentacionit që duhet të paraqesë shoqëria gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Leja e përpunimit bëhet në dy kopje, njërën nga të cilat e merr shoqëria, ndërsa tjetra ruhet në arkivin e ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, së bashku me tërë dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria anonime.

9. Shoqëria e pajisur me leje përpunimi detyrohet të dërgojë periodikisht të dhëna për veprimtarinë e vet në Drejtorinë e Përgjithshme të Hidrokarbureve. Lloji i të dhënave, forma dhe afatet e dërgimit të tyre nga shoqëritë përcaktohen nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet.

10. Shoqëria e pajisur me leje përpunimi ka detyrimin të njoftojë, brenda 30 ditëve, ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet për çdo ndryshim që i referohet pikës 1 të kreut II të këtij vendimi.

11. Shoqëria e pajisur me leje përpunimi mund ta shtojë gamën e nënprodukteve që përpunon pas reflektimit të tyre në lejen e dhënë.

Për këtë qëllim, shoqëria duhet të paraqesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Hidrokarbureve këto dokumente:

a) Projektin teknologjik të linjave shtesë, të miratuar nga organet e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe të mjedisit, pranë njësisë së qeverisjes vendore.

b) Vërtetimin nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës dhe të Gazit, për respektimin e normave dhe të kushteve teknike për linjat shtesë.

c) Listën e nënprodukteve shtesë që do të përpunohen.

III. Pagesat

Dhënia e lejeve të përpunimit të nënprodukteve e naftës bëhet kundrejt pagesës nga subjekti kërkuar. Tarifa e pagesës për dhënien rishtas të lejes së përpunimit është 200 000 (dyqind mijë) lekë, ndërsa tarifa për ripërtëritjen e lejes së përpunimit është 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Të ardhurat që realizohen nga pagesat e këtyre tarifave përdoren në përputhje me vendimin nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

IV. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM Nr.735, datë 5.11.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, rrjetit rrugor kombëtar t’i shtohet edhe “24 km” rrugë.

2. Në lidhjen 1 “Rrjeti rrugor kombëtar”, që i bashkëlidhet vendimit, shtohet emërtimi:

“Drejtorisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve, Elbasan
Elbasan-Gjinar 24 km rrugë interurbane, dytësore.”.

3. Në tabelën “Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale”, që i bashkëlidhet vendimit, hiqet emërtimi “Elbasan-Gjinar”.

Ky vendim hyn në fuqi në 1 janar 2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.748, datë 11.11.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.190, DATË 3.5.1995 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7874, DATË 17.11.1994 “PËR STATUSIN E
VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT
SHQIPTAR”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 14 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 26 të vendimit nr.190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe stafi teknik i tij, në përjashtim nga sa është thënë në paragrafët e mësipërm, të vazhdojë veprimtarinë edhe për vitin 2004 deri më 31.12.2006, vetëm për personat që e fitojnë këtë status me vendim gjykatë të formës së prerë.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.750, datë 11.11.2004

PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE TË PËRDORË
PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”, PËR RIKONSTRUKSIONIN E URËS
SË RRJOLLIT NË SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve që, për fondin prej 31 000 000 (tridhjetë e një milion) lekësh, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë ndërtuese “EUROSTAR”, për kryerjen e punimeve të rikonstruksionit të urës së Rrjollit në Shkodër.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “Investime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.

3. Punimet të përfundojnë brenda vitit 2004.

4. Ngakohen Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, Ministri i Ekonomisë, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.752, datë 11.11.2004

PËR SHPALLJEN “ANSAMBËL HISTORIK” DHE “ZONË E STIMULUAR” TË
PALLATIT TË BRIGADAVE DHE TË PARKUT TË TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” dhe të nenit 2 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pallati i Brigadave dhe parku i tij të shpallen:

- a) “Ansambël historik” dhe të vendosen nën mbrojtjen e shtetit;
- b) “Zonë e stimuluar”, me përparësi zhvillimin e turizmit.

2. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, të hartojnë dhe të propozojnë programin e masave për restaurimin e Pallatit të Brigadave dhe të parkut të tij dhe kthimin e tyre për destinacion turistik.

3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dhe të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave rregulloren e administrimit të këtij ansambli historik.

4. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.15, datë 10.11.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 20.7.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.20 Akti që i përket:

KËRKUES: ARBEN POPAJ, përfaqësuar nga avokat Fatos Shanaj me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.32, datë 4.3.2003 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.308, datë 6.6.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nenit 131/f, 31/ç e d të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 27 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi, nëpërmjet avokatit të tij, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve:

- Gjykata e Apelit ka cenuar të drejtën e mbrojtjes duke caktuar si avokat një person që kishte mbrojtur më parë të pandehurin tjetër, deklarimet e të cilit ishin prova fajësie për kërkuesin.

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka kaluar çështjen për gjykim, megjithëse në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë janë pretenduar shkelje të rënda kushtetuese që kanë të bëjnë me garantimin e së drejtës themelore për t’u mbrojtur dhe me pavlefshmërinë absolute të akteve të hetimit e të gjykimit.

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Shkodër, me vendimin nr.157, datë 17.6.2002, ka deklaruar fajtor të gjykuarit Paulin Bujaj e Gëzim Naçaj për veprat penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim, e për armëmbajtje pa leje, duke i dënuar përkatësisht me burgim të përjetshëm dhe 22 vjet burgim. Së bashku me ta, është deklaruar fajtor dhe është dënuar me dy vjet burgim për veprën penale të sigurimit të kushteve e mjeteve për vrasje të kryer në bashkëpunim.

Si në seancën e vlerësimit të masës së sigurimit, ashtu edhe në gjykimet e çështjeve në gjykatën e rrethit dhe të apelit, të gjykuarit janë mbrojtur me të njëjtin avokat.

Megjithëse prokuroria e gjykatat kanë pranuar se të lartpërmendurit veprat penale i kanë kryer në bashkëpunim me kërkuesin Arben Popaj, çështja penale në ngarkim të këtij të fundit u veçua dhe u dërgua për gjykim pasi kishte mbaruar gjykimi i tre të lartpërmendurëve në Gjykatën e Shkallës së Parë në Shkodër. Kjo e fundit, me vendimin nr.281, datë 14.11.2002, e deklaroi kërkuesin të pafajshëm për veprën penale të sigurimit të kushteve e mjeteve për vrasje, në bashkëpunim, sipas neneve 80-25 të Kodit Penal.

Mbi apelimin e prokurorit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.32, datë 4.3.2003 ndryshoi vendimin nr.281, datë 14.11.2000 të gjykatës së shkallës së parë, duke e deklaruar kërkuesin fajtor për veprën penale të sigurimit të kushteve e mjeteve materiale për vrasje dhe duke e dënua atë me një vit burgim.

Gjykata e apelit, ndonëse përmend si prova fajësie vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për dënimin e tre të lartpërmendurëve, aktet e procedimit penal nr.285 në ngarkim të tyre, si dhe aktet shkresore të procesit për caktimin e masës së sigurimit të tyre, i cakton kryesisht kërkuesit si mbrojtës avokatin e të gjykuarve Paulin Bujaj e Kelmend Çelaj. Caktimi i këtij avokati vjen në kundërshtim me nenin 54 të Kodit të Procedurës Penale, sepse midis të gjykuarve të mbrojtur më parë prej tij dhe kërkuesit ka pasur papajtueshmëri interesash. Kjo papajtueshmëri konstatohet në faktin që, ndërsa kërkuesi nuk e pranon akuzën, të gjykuarit e mëparshëm e implikojnë atë në rolin e bashkëpunorisë në veprën penale të vrasjes së kryer prej tyre. Në këto rrethana, pjesëmarrja në gjykimin e kërkuesit e të njëjtit avokat cenon edhe parimin kushtetues për një proces të rregullt ligjor parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut. Detyra e organit procedues, sipas rregullave procedurale është të krijojë mundësitë që avokati të zbatojë me korrektesë detyrat e tij duke qenë figurë e respektuar procedurale e aftë për të dhënë ndihmën e kualifikuar juridike dhe për të zhvilluar një debat konstruktiv. Për sa sipër, gjykata në rastin konkret duhet të caktonte një mbrojtës tjetër i cili të mos ishte i ndikuar nga mbrojtja e të gjykuarve të tjerë me të cilët i akuzuari mbante qëndrim të kundërt në të njëjtën vepër penale.

Sipas përmbajtjes së nenit 6 paragrafi “b” të Konventës europiane të të drejtave të njeriut dhe neneve 49 e 54 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata duhet të krijojë mundësitë që avokati të bëjë një mbrojtje sa më të efektshme. Ndihma juridike që i jepet të akuzuarit dhe që kërkohet në prizmin e interesit të drejtësisë e të rolit të rëndësishëm për një proces të rregullt ligjor në një shoqëri demokratike duhet të jetë pa paragjykime, praktike e efikase, dhe jo vetëm iluzore¹. Këto kërkesa nuk janë realizuar në shyrtrimin e çështjes në gjykatën e apelit, ku avokati i caktuar kryesisht, menjëherë pas fillimit të seancës gjyqësore, është kufizuar vetëm me kërkesën për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit.

Në rekursin e paraqitur para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka pretenduar shkelje të rënda të Kushtetutës e të Kodit të Procedurës Penale, që kanë të bëjnë me caktimin kryesisht të një mbrojtësi, i cili kishte qenë avokat i një të pandehuri me të cilin ai ka papajtueshmëri interesash, me marrjen e të dhënave kundër tij në prokurori nga personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime pa praninë e mbrojtësit etj. Megjithëse këto pretendime mbështeteshin te të dhënat e dosjes, konstatohet se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka marrë çështjen në shqyrtim në seancë plenare.

Në këto rrethana, vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër dhe i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) duhen shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën.

¹ Vendimi “Airey kundër Holandës”, datë 9.10.1979, A 32, paragrafi 24

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 132 të Kushtetutës dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash;

VENDOSI :

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.32, datë 4.3.2003 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.308, datë 6.6.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e akteve të çështjes në Gjykatën e Apelit Shkodër.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kam mendim të kundërt me vendimin që mori Gjykata Kushtetuese me shumicë votash.

Konkluzioni i saj se në gjykimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesit Arben Popaj është shkelur e drejta e tij themelore për një proces të rregullt ligjor, nuk është i bazuar.

Në këtë vendim ajo ka pranuar se kjo shkelje kushtetuese konsiston në faktin se gjykata e apelit ka caktuar kryesisht si mbrojtës të kërkuesit, avokat Gjon Lepurin, ndonëse ky në një çështje tjetër penale që ka lidhje me atë në ngarkim të kërkuesit, ka mbrojtur dy të pandehur të tjerë, me të cilët kërkuesi ka pasë papajtueshmëri interesash.

Për sqarimin e kësaj rrethane, u administruan në seancë plenare dy dosjet gjyqësore të këtyre çështjeve, mirëpo nga materialet që ndodhen në to, rezulton e kundërta. Në këto gjykime, si kërkuesi, ashtu edhe dy të pandehurit e tjerë kanë mbajtur secili qëndrime të ndryshme. Megjithatë, në këtë fazë të procesit, asnjëri prej këtyre të fundit nuk ka bërë atribuime në dëm të kërkuesit, nuk e ka implikuar këtë si bashkëpunëtor në veprën penale të vrasjes ose si autor të ndonjë veprë tjetër penale që të ketë pasur lidhje me të parën. Mbi këtë bazë, kur gjatë këtyre gjykimeve nuk është vërtetuar ndonjë papajtueshmëri interesash midis personave të lartpërmendur, marrja e tyre në mbrojtje nga i njëjti avokat, nuk përbën shkelje në kuptim të nenit 54 të Kodit të Procedurës Civile dhe për rrjedhojë proces jo të rregullt ligjor.

Fakti se dy ose njëri prej të pandehurve të mësipërm gjatë fazës fillestare të hetimit kanë bërë atribuime të kësaj natyre në adresë të kërkuesit, nuk ka rëndësi për çështjen. Përderisa në gjyqin e zhvilluar kundër tyre, ata i kanë ndryshuar këto thënie, duke mohuar në mënyrë kategorike pjesëmarrjen ose implikimin e kërkuesit ngjarjen për të cilën janë gjykuar, deklaratimet e tyre në hetuesi kanë humbur çdo vlerë provuese. Kjo për arsye se me Kodin e ri të Procedurës Penale është pranuar parimi se provat formohen në gjyq. Pra, në gjykimin e çështjeve penale është hequr dorë nga kërkesat e procesit të mëparshëm inkuizitor dhe veprojnë ato të procesit akuzator.

Avokati Gjon Lepuri ka marrë pjesë vetëm në gjyq dhe nuk ka mbrojtur në hetuesi asnjërin prej tre të pandehurve. Në gjyq as ai, as gjykatat nuk kanë konstatuar papajtueshmëri interesash midis tyre. Në mbrojtjen që u ka bërë atyre, avokati në fjalë nuk ka përdorur si argument atributimin në hetuesi të njërit në favor të tjetrit, por në kërkimet e tij përfundimtare është mbështetur në qëndrimin që ata kanë mbajtur në gjyq.

Për këto arsye, unë jam i mendimit për rrëzimin e kërkesës.

GJYQTAR
Zija Vuci

VENDIM
Nr.16, datë 11.11.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 14.6.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.15 Akti që i përket:

KËRKUES: KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT, përfaqësuar me prokurë nga z. Njazi Jaho.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga z.Viktor Gumi.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar me autorizim nga Avokati i Shtetit z.Kosta Gazeli.

3. INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE I KONTROLLIT TË PASURIVE, përfaqësuar nga Inspektorja e Përgjithshme znj.Fatmira Laska, me autorizim.

4. NJË GRUP ORGANIZATASH JOFITIMPRURËSE:

a. INSTITUTI PËR STUDIME BASHKËKOHORE

b. INSTITUTI PËR STUDIME DEMOKRATIKE

c. ZYRA PËR MBROJTJEN E QYTETARËVE

d. QENDRA PËR STUDIME PARLAMENTARE

e. INSTITUTI SHQIPTAR I TEKNOLOGJIVE TE INFORMACIONIT, f. I.D.R.A.

g. AKSES, të përfaqësuar me prokurë nga avokat Enkelejd Alibeaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 34 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

BAZA LIGJORE: Neni 35 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni 8 i Konventës europiane për të drejtat e njeriut, nenet 131 germa “a” dhe 134 (pika 1 germa “f” dhe pika 2) të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenet 27-31 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Për shfuqizimin si antikushtetues të dispozitës së mësipërme, kërkuesi ka paraqitur këto shkaqe:

- Të dhënat pasurore janë të dhëna personale, prandaj publikimi i tyre duhet bërë në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Për rrjedhojë, trajtimi i tyre nga persona të tjerë mund të lejohet vetëm me pëlqimin e subjektit deklarues.

- Për të qenë e justifikueshme ndërhyrja shtetërore në jetën private, duhen plotësuar kriteret e nenit 8 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut, pasi kemi të bëjmë me të drejtën e privatësisë dhe jo me të drejtën e informimit.

- Në raport me nenin 34, është i dyshimtë në kushtetutshmërinë e tij edhe neni 22 i ligjit nr.9049, që përmban detyrimin e deklarimit të pasurisë së anëtarëve të familjes së deklaruesit, kur kjo pasuri është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, si dhe neni 8 që kërkon deklarimin e pasurisë për një kohë 2 deri në 4-vjeçare edhe të personave të larguar nga funksioni.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e kërkuarit, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka aprovuar ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i cili ka hyrë në fuqi me datë 30.5.2003.

Mbështetur në nenin 131/a, 134 pika 1“f” dhe pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese të deklarojë si antikushtetues nenin 34 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, me titull “Publikimi”, në të cilin theksohet se: “Të dhënat që përfitohen nga deklarimi sipas këtij ligji janë të lejueshme për publikun, në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare””.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është organizatë jofitimprurëse, e njohur për aktivitetin e saj në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Ai është legjitimuar në paraqitjen e kërkesave analoge pranë Gjykatës Kushtetuese “për çështje që lidhen me interesat e tij”, kur konstatohet se pretendimet e parashtruara lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, gjë që sipas statutit të kësaj organizate përbën edhe objektin kryesor të veprimtarisë së saj.

Duke pasur parasysh natyrën e kërkesës, si dhe argumentet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit për papajtueshmëri me Kushtetutën të nenit 34 të ligjit nr.9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, Gjykata Kushtetuese çmon se, përveç ligjit në fjalë, çështja në tërësinë e saj kërkon një analizë më të hollësishme të lirisë së shprehjes dhe të marrjes së informacionit (nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës dhe neni 10 i Konventës europiane të të drejtave të njeriut), lirisë së respektimit të jetës private dhe familjare (neni 35 i Kushtetutës dhe neni 8 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut), raportit që krijohet në rastin konkret për shkak të përplasjes apo interferimit të elementeve të veçanta të këtyre dy të drejtave themelore me njëra-tjetrën (neni 17 i Kushtetutës dhe paragrafi i dytë i nenit 8 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut), si dhe të disa dispozitave të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe të ligjit nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Referimi në Konventën europiane të të drejtave të njeriut (për rrjedhojë edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut) bëhet jo vetëm për shkak të paraqitjes së argumenteve nga kërkuari, por edhe në funksion të vendit të privilegjuar që kanë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në tërësinë e akteve normative që kanë fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë (shih nenet 116 dhe 122 të Kushtetutës).

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë vlerëson se kërkesa e Komitetit Shqiptar të Helsinkit duhet rrëzuar për këto arsye:

1. Liria e shprehjes përbën një nga gurët themelorë të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike).¹⁾ Shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efikase për të kontrolluar demokracinë si formë e qeverisjes. Nëpërmjet tyre, pushteti shtetëror bëhet më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit. Liria e shprehjes është gjithashtu bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejta dhe liri të tjera themelore. Për këtë arsye, zbatimi në praktikë i kësaj të drejte kërkon në çdo rast një kuptim dhe interpretim mjaft të gjerë.

Sipas nenit 10 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut, liria e shprehjes përfshin në vetvete edhe të drejtën e informimit, si një e drejtë themelore për të marrë dhe për të dhënë informacion pa ndërhyrjen e autoriteteve publike. Një deklaram i përafërt me këtë bëhet edhe në nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën 217 A (III), datë 10.12.1948. E drejta e informimit, ndër elementet e saj kryesore ka lirinë personale për të marrë informacion, lirinë personale për të dhënë informacion dhe lirinë e shtypit ose, thënë ndryshe, të drejtën e medias për të marrë e dhënë informacion. Kjo e fundit trajtohet gjithnjë si e drejtë më vete, për shkak të rolit të veçantë që luan media në një shoqëri të lirë e demokratike.

Pozicioni i “privilegjuar” i medias në shtetin demokratik garantohet, për shkak se është pikërisht ajo që e bën pushtetin shtetëror më të prekshëm për njerëzit, më të kontrollueshëm dhe më transparent. Media ndikon që individët e angazhuar në të tre pushtetet, si persona të zgjedhur apo zyrtarë, të kenë disa cilësi të reja. Ata janë më afër me median, më të komunikueshëm me njerëzit, më të kujdesshëm në përmbushjen e detyrave dhe të funksioneve të tyre, si dhe në jetën dhe angazhimet e tjera shtetërore e private. Media është gjithashtu një bazë e rëndësishme për të kontrolluar dhe gjykuar se si funksionarët e veshur me pushtet, ushtrojnë autoritetin publik dhe si i menaxhojnë fondet publike. Garantimi i lirisë së medias, ndër të tjera, zvogëlon mundësinë e manipulimeve me pushtetin publik, si dhe nxit identifikimin e rasteve korruptive. Arma e saj më e fuqishme është kritika e vazhdueshme ndaj dukurive negative që rrezikojnë demokracinë si formë e qeverisjes.

Në dallim nga Konventës europiane të të drejtave të njeriut, Kushtetuta jonë garanton lirinë e shprehjes në kuptim të ngushtë dhe të drejtën e informimit në dy dipozita të veçanta, respektivisht në nenet 22 dhe 23 të saj.

Liria e shprehjes dhe e drejta e informimit, përveç garancisë subjektive si të drejta kushtetuese themelore, janë të lidhura objektivisht edhe me parimin e ndërtimit të një shteti demokratik, të deklaruar në preambulën e Kushtetutës sonë. Zbatimi i këtij parimi të rëndësishëm nënkupton edhe garantimin e lirisë së shprehjes, lirinë e shtypit dhe të drejtën e informimit si të domosdoshme për një rend të lirë e kushtetues.

Mbi bazën e dispozitave respektive kushtetuese, liria e shprehjes dhe e drejta e informimit gjejnë rregullim më të detajuar në disa ligje të veçanta të miratuara në periudhën vijuese (pas aprovimit të Kushtetutës) nga Kuvendi, mes të cilave mund të përmendej ligji nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”; ligji nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; ligji nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, etj. Në tërësinë e tij, legjislacioni shqiptar synon të garantojë një nivel bashkëkohor të së drejtës së informimit.

2. E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare përbën edhe sot një nga sfidat e shteteve të lira e demokratike, veçanërisht të demokracive të reja. Garantimi i kësaj të drejte themelore është edhe një reflektim ndaj përvojës negative të regjimeve totalitare e diktatoriale,

¹ shih Handyside v.Mbreterise së Bashkuar, 7.12.1976, Seria A no.24, fq.23, Jersild v. Danimarkës, 23.09.1994, Serie A.no., etj.

tendenca e të cilëve ka qenë ndërhyrja ekstreme edhe në çështjet apo vendimet intime personale apo familjare.

Në ndryshim nga formulimi i bërë në nenin 12 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ku ndër të tjera thuhet se: “Askush nuk mund të jetë objekt i ndërhyrjes arbitrare në jetën e tij private, në familje,...”, në nenin 8 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut theksohet: “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”. Një formulim i tillë, që ndryshon edhe nga mënyra e garantimit të të drejtave të tjera themelore që përmban Konventa europiane e të drejtave të njeriut, është bërë qëllimisht për të evidentuar jo vetëm detyrimin negativ të autoriteteve publike për të mos ndërhyrë në jetën private dhe familjare, por edhe detyrimin pozitiv shtetëror për t'i mbrojtur këto të drejta sa më realisht, përmes organeve të të tre pushteteve: ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se, për mbrojtjen e kësaj të drejte dhe për arritjen e konkluzioneve për çështjen në gjykim, rëndësi të veçantë merr edhe përcaktimi i nocionit të jetës private. Duhet theksuar, me këtë rast, se ky nocion nuk ka karakter shterues. Ai ka ardhur duke u zgjeruar vazhdimisht jo vetëm përmes jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të drejtave të njeriut, por edhe nga zhvillimet e diferencuara ligjore dhe jurisprudenciale të vetë shteteve palë në Konventës europiane të të drejtave të njeriut. Megjithatë, në përgjithësi, pranohet se e drejta për respektimin e jetës private në thelbin e saj duhet t'i sigurojë individit një hapësirë, brenda së cilës ai do të mund të zhvillonte dhe plotësonte në mënyrë të pavarur personalitetin e tij. Sigurisht që këtu përfshihet edhe zhvillimi apo ruajtja në një masë të caktuar e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë¹. Pra, respektimi i jetës private kërkon në parim mosndërhyrjen në vendimet që merr vetë individi rreth mënyrës së bërjes së jetës së tij.

Mbrojtja e jetës private dhe familjare, në Kushtetutën tonë, bëhet përmes disa dispozitave, veçanërisht nga neni 35 (mbrojtja e të dhënave personale), neni 36 (liria dhe fshehtësia e korrespondencës), neni 37 (paprekshmëria e banesës), neni 53 (mbrojtja e martesës dhe i familjes), etj.

Për çështjen në gjykim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se është e nevojshme të analizohet neni 35 i Kushtetutës, në të cilin, që në parafin e parë, deklarohet se: “Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij”.

Padyshim që edhe në këtë rast, në parim, qëllimi i hartuesve të Kushtetutës ka qenë pikërisht garantimi i asaj hapësire të nevojshme, brenda së cilës individi do mund të zhvillonte në mënyrë të pavarur personalitetin e tij. Në këtë kuadër, sigurisht që është e drejtë e individit të vendosë vetë për mënyrën dhe masën e paraqitjes së tij si person para të tjerëve dhe publikut në tërësi.

Eshtë me rëndësi të ritheksohet se “me të dhëna që lidhen me personin e tij” duhet të kuptohen në radhë të parë dhe kryesisht të dhënat me karakter sensitiv, të tilla si origjina racore dhe etnike, bindjet, përkatësitë politike, bindjet fetare, gjendja shëndetësore, jeta seksuale dhe gjendja penale, (shih nenin 2/b të ligjit nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”), të dhënat e grumbulluara në mënyrë të justifikueshme nga autoritetet kompetente shtetërore, etj.

Të dhënat mbi të ardhurat apo pasurinë kanë karakter personal. Për rrjedhojë, ato përfshihen në hapësirën e gjerë që mbron neni 35 i Kushtetutës. Si rregull, bërja e tyre publike kërkon pëlqimin e vetë personit të interesuar.

Gjykata Kushtetuese vë në dukje gjithashtu se vetë neni 35 i Kushtetutës, krijon mundësinë e bërjes publike të të dhënave personale edhe pa pëlqimin e personit, nëse një gjë të tillë “e kërkon ligji” (paragrafi 1) ose në rastet e “parashikuara me ligj” (paragrafi 2). Një kufizim i tillë, në kushte të caktuara, gjen mbështetje edhe nga neni 17 i Kushtetutës (kufizimi të bëhet “...vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve....”).

Duke pasur parasysh edhe Konventës europiane të të drejtave të njeriut, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të drejtave të njeriut, vlerësohet se rastet që do të justifikonin

¹ Shih Frowein – Peukert - EMRK Kommentar, Engel Verlag 1996, fq. 339.

në tërësi kufizimin me ligj të kësaj të drejte do të ishin siguria kombëtare, mirëqenia ekonomike e vendit, mbrojtja e rendit kushtetues, parandalimi i veprave penale, mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të të tjerëve, etj. Në çdo rast konkret, legjitimitimi ose jo i ndërhyrjes do të varej kryesisht nga intensiteti i saj, shkalla e cenimit të jetës private, domosdoshmëria e kësaj ndërhyrjeje në shoqërinë demokratike dhe në realitetin konkret që e ka diktuar atë, efektiviteti dhe proporcionaliteti në raportin e qëllimit që është synuar të arrihet dhe mjeteve të përdorura për arritjen e tij. Mbi të gjitha duhet pasur parasysh se sa më shumë të depërtohet në sferën e jetës intime apo sensitive, aq më shumë rritet edhe detyrimi i pushtetit publik për mbrojtjen e jetës private.

3. Gjykata Kushtetuese çmon se, në rastin konkret, kufizimi i së drejtës së jetës private në formën e deklarimit të pasurisë dhe mosmarrjes së pëlqimit për publikimin e mundshëm të të dhënave personale për tre kategori personash (subjekti deklarues, familjarët e tij dhe personat e lidhur me të) në përputhje me ligjin “Mbi të drejtën e informimit”, vjen për shkak të interferimit me njëra-tjetrën të dy vlerave të rëndësishme kushtetuese apo dy të drejtave themelore të analizuara më sipër, të garantuara si nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe nga Konventa europiane e të drejtave të njeriut. Prandaj duhen përcaktuar kriteret apo standardet që duhen pasur parasysh për të vlerësuar se cila nga këto dy vlera kushtetuese, në një realitet konkret, ka përparësi ndaj vlerës tjetër. Për vendosjen e këtij raporti apo për zgjidhjen e çështjes se legjitimiti ose jo të kësaj ndërhyrjeje, para së gjithash duhet të bëhet referimi në parimin kushtetues të proporcionalitetit, i cili gjen zbatim veçanërisht efektiv në fushën e të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër, ai shërben si masë kontrolli kushtetues edhe për veprimtarinë legjislative të Kuvendit.

Për këtë arsye, është e nevojshme që në bazë të metodës objektivo-teologjike, të evidentohet kuptimi dhe qëllimi kryesor që synon të arrijë ligjvënësi përmes këtij ligji në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë edhe përmes ndërhyrjes në sferën e jetës private. Mbi këtë bazë duhet argumentuar nëse kjo ndërhyrje apo ky mjet i përdorur është i domosdoshëm, i përshtatshëm, proporcional dhe efektiv. Një gjë e tillë arrihet përmes kriterit balancues, i cili bën të mundur të peshohen e vlerësohen sa më drejt të mirat e përgjithshme apo interesat publike që mbrohen në raport me të drejtën e kufizuar. Një e drejtë apo interes, sado me rëndësi publike apo me vlerë që të jetë, nuk mund të peshojë në mënyrë disproporcionale me një të drejtë apo interes tjetër të mbrojtur nga kushtetuta dhe ligji. Marzhi i këtij vlerësimi, dhe për rrjedhojë edhe raporti që krijohet ndërmjet interesit të mbrojtur dhe atij të cenuar, ndryshon në çdo rast konkret. Ai varet nga një sërë rrethanash dhe kushtesh që ndryshojnë nga një vend në një tjetër, nga një periudhë e caktuar kohore në një tjetër, nga rangu i të drejtave që vendosen në balancë, si dhe pasojat që do të kishte përparësia e secilës prej tyre.

4. Gjykata Kushtetuese konstaton se qëllimi kryesor për miratimin e ligjit nr.9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” ka qenë marrja e masave sa më efektive për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, rritja e besimit në institucionet shtetërore, transparencë, parandalimi i rasteve të abuzimit me pushtetin shtetëror dhe pasurimit të paligjshëm të personave të zgjedhur ose të atyre që kryejnë funksione të caktuara shtetërore. Këto fenomene të dëmshme pengojnë zhvillimin e vendit, mirëqenien e përgjithshme dhe ndërtimin e një shteti të lirë e demokratik. Prandaj ligjvënësi ka synuar që në këtë betejë të rëndësishme për fatet e demokracisë në Shqipëri t’i sigurohet një pjesëmarrje aktive edhe publikut. Kjo pjesëmarrje garantohet përmes transparencës, njohjes dhe vlerësimit të publikut të gjerë edhe me të dhënat mbi deklaratimet e pasurisë së personave të zgjedhur apo zyrtarë.

Deklarimi i pasurisë dhe mundësia e publikimit të të dhënave të deklaratës në përputhje me ligjin nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, është gjithashtu një ndihmesë për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesave. Në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, personi i zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesat e ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund

të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizikë dhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike. Deklarimi dhe regjistrimi i pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, verifikimi i tyre, si dhe mundësia e bërjes publike të të dhënave që kanë këto deklarime ndikojnë pozitivisht në identifikimin ose shmangien e rasteve të konfliktit të interesave, pra edhe të rasteve korruptive.

Të dhënat personale me karakter pasuror, si rregull, hyjnë në sferën e jetës private, prandaj në rastin konkret gjen zbatim neni 35 i Kushtetutës dhe neni 8 i Konventës europiane të të drejtave të njeriut. Megjithatë, ato nuk kanë atë natyrë dhe atë karakter që kanë të dhënat me karakter sensitiv, të cilat përbëjnë edhe thelbin e jetës private dhe familjare. Janë pikërisht këto të dhëna, të cilat i krijojnë mundësi individit të zhvillojë në mënyrë të pavarur personalitetin e tij dhe që “në mënyrë të bazuar dhe të njohur nga të tretët, nuk mund të jenë nën vëzhgimin e publikut”¹. Të dhënat pasurore në tërësinë e tyre nuk e kanë këtë karakter. Për më tepër, në tërësi shpesh ato janë vetiu nën vëzhgimin dhe vlerësimin e publikut të gjerë. Nga ana tjetër, marzhi i vlerësimit në këtë rast është dhe duhet të jetë shumë më i gjerë dhe tolerues, pasi bëhet fjalë për persona të rëndësishëm publikë, të veshur me pushtet të konsiderueshëm shtetëror. Transparenca dhe besimi i publikut në këtë kategori njerëzish luajnë rol të rëndësishëm në shtetin e lirë e demokratik. Pikërisht për këtë arsye, në jurisprudencën e vendeve të ndryshme demokratike është deklaruar se “publikimi i detajeve mbi të ardhurat ose pasurinë personale nuk përbën ndërhyrje në jetën private, veçanërisht nëse personi ushtron funksione publike ose kuazi – publike”².

Gjykata Kushtetuese ka parasysh se kufizimi që i bëhet jetës private në formën e deklarimit dhe mundësisë së publikimit të të dhënave personale me karakter pasuror të subjekteve të caktuara është bërë me ligj, ashtu siç kërkohet edhe nga nenet 17 dhe 35, respektivisht paragrafi i parë dhe i dytë i Kushtetutës sonë, si dhe nga paragrafi i dytë i nenit 8 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut. Konstatohet gjithashtu se qëllimi i synuar justifikon plotësisht miratimin e një ligji të tillë. Nga ana tjetër, vlerësohet se mjetet e përdorura për arritjen e këtij qëllimi legjitim, pra kërkesat për deklarimin e pasurisë së subjekteve të caktuara, burimeve të saj dhe mundësia e publikimit të tyre, janë efektive dhe në proporcion me këtë qëllimin e synuar. Ligjvënësi ka treguar kujdes në balancimin sa më të drejtë të së drejtës themelore të informimit dhe të detyrimit për respektimin e jetës private. Në balancimin ndërmjet këtyre dy të drejtave themelore, është pasur parasysh kontributi që sjell deklarimi i pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, i burimeve të saj, si dhe publikimi i tyre në debatin e përgjithshëm, duke u kthyer kështu në mjet për arritjen e qëllimeve që synohen në rastin konkret. Detyrimi për deklarimin e të ardhurave dhe pasurisë personale, si dhe mundësia e publikimit të tyre nuk synojnë dëmtimin apo denigrimin e subjekteve deklaruese, por një transparencë dhe kontroll më rigoroz ndaj pasurimit apo raporteve të tyre financiare me persona të tretë. Nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon se publiku ka interes të ligjshëm që përmes transparencës të informohet më në detaje jo vetëm mbi punën dhe veprimtarinë, por edhe mbi të ardhurat, pasurinë dhe burimet e saj të personave të zgjedhur ose zyrtarë. Pra, balanca e gjetur vlerësohet si e drejtë dhe e bazuar.

Për rrjedhojë, konstatohet se ndërhyrja apo kufizimi i sferës së jetës private në formën e dhënies së informacionit mbi pasurinë dhe burimet e saj, si dhe mundësia e publikimit të tyre të jenë të justifikuara dhe të domosdoshme në kushtet aktuale të shoqërisë shqiptare.

5. Kërkuesi ka pretenduar se neni 34 i ligjit nr.9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” është antikushtetues edhe për shkak se publikimi i të dhënave mund të bëhet pa pëlqimin e subjektit deklarues, gjë që sipas tij bie ndesh me nenin 35 të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese thekson se edhe

¹ Carolina e Monacos kundër Gjermanisë – Aplikimi nr.59320/00.

² Vendim i Gjykatës Franceze të Kasacionit, cituar nga GjEDrNj në çështjen Frezzos & Roire kundër Francës. Aplikimi 29183/1995

ky pretendim nuk qëndron. Ajo rithekson se një kufizim i tillë është në përputhje dhe bazohet në nenin 35 paragrafi i dytë i Kushtetutës (parashikohet në ligj), në nenin 17 paragrafi i dytë i Kushtetutës (nuk e cenon thelbin e së drejtës për privatësi dhe nuk i tejkalon kufizimet e parashikuara në Konventës europiane të të drejtave të njeriut), si dhe nenin 8 paragrafi i dytë i Konventës europiane të të drejtave të njeriut, (kufizimi synon mirëqënien ekonomike të vendit, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, etj). Për më tepër, vlerësohet se, në këtë rast, ligjvënësi ka pasur parasysh edhe nenin 11 pika “b” të ligjit nr.8517 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ku radhitet si një nga rastet kur nuk është e domosdoshme dhënia e pëlqimit paraprak për trajtimin ose publikimin e të dhënave personale edhe atëhere kur një gjë e tillë është e “nevojshme për përmbushjen e një detyrimi ligjor të vete subjektit të të dhënave”. Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh se në nenin 5 të ligjit nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” theksohet qartë se: “Çdo person ka të drejtë të informohet për të dhënat vetjake të personave që kryejnë funksione shtetërore ose shërbime publike, për aq sa këto të dhëna lidhen me cilësi të kërkuara nga ligji ose nga një akt nënligjor për personat që i ushtrojnë këto detyra”. Në këtë kuptim, rezulton se Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe i Kontrollit të Pasurive nuk bën dhe nuk mund të bëjë publike me iniciativën e tij të dhënat që përmban deklarata vetjake e subjektit deklarues. Këto të dhëna jepen vetëm në bazë të kërkesës së bërë (nga publiku) dhe në përputhje me kriteret kushtetuese e ligjore për çdo rast konkret, por sigurisht pa qenë nevoja e dhënies së pëlqimit paraprak nga subjekti deklarues. Detyrimi i nenit 10 të ligjit nr.9049 për dhënien e një autorizimi të veçantë nga subjekti deklarues, përmes të cilit autorizohen organet përkatëse të verifikojnë të dhënat e deklaruara, nuk ka të bëjë me dhënien e pëlqimit për publikimin e të dhënave personale, por me vlefshmërinë dhe kontrollin e tyre nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe i Kontrollit të Pasurive apo çdo organ tjetër shtetëror që parashikohet me ligj. Pa këtë autorizim do të bëhej pothuajse i pamundur ky proces, veçanërisht në mekanizmat respektive jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

6. Në nenin 34 të ligjit nr.9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” me titull “Publikimi”, theksohet se: “Të dhënat që përfitohen nga deklarimi... janë të lejueshme për publikun në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare””. Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky referim nuk është antikushtetues. Ai është në përputhje me synimin kryesor të ligjvënësit në hartimin e këtij ligji, për t’i dhënë prioritet të drejtës së informimit, (pra interesit të përgjithshëm publik), ndaj interesave private, të shprehura në këtë rast, në formën e deklarimit dhe të publikimit të mundshëm të të dhënave personale mbi të ardhurat dhe pasurinë e subjekteve deklaruese. Edhe nga ana formale, po në këtë ligj theksohet ndër të tjera se deklaratat e pasurisë dhe të gjitha dokumentet e tjera që i shoqërojnë ato “janë dokumente zyrtare” (neni 38). Për këto arsye, referimi në ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” përbën garanci që publikimi i mundshëm i këtyre deklarimeve nuk do të bëhet në mënyrë arbitrare, por në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve të tjera në fuqi, në disa prej të cilëve të referon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë edhe ligji nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Kështu, neni 4 i këtij ligji lejon kufizimin e së drejtës së informimit tërësisht ose pjesërisht mbi një dokument të caktuar zyrtar, përfshirë edhe deklaratat e pasurisë, nëse aty ka të dhëna, botimi i të cilave ndalohej edhe nga një ligj tjetër, të dhëna që përbëjnë sekret shtetëror, të dhëna me karakter sensitiv, etj). Kufizimi i pjesshëm apo tërësor i së drejtës së informimit në këto raste, duhet të arsyetohet nga autoriteti përkatës. Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh se në përputhje edhe me nenin 4 të ligjit 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare”, si rregull bëhet publike ajo çka përbën thelbin e informacionit mbi pasurinë dhe burimet e saj të deklaruara nga subjekti përkatës, pa hyrë në detaje të panevojshme ose elemente të deklarimit që mund t’i shërbejnë (për verifikim dhe kontroll) Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive ose autoriteteve të tjera publike, por që në vetvete nuk paraqesin interes për publikun.

Është detyrë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive që në përputhje me ligjin nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe legjislationin në fuqi në tërësi, përfshirë këtu edhe ligjin nr.8517 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të përcaktojë kushtet, kriteret, procedurat dhe afatet e dhënies së informacionit mbi deklaratat e pasurisë së individëve, subjekte të këtij ligji. Nga ana tjetër, kriteret e mësipërme dhe kërkesat ligjore duhen pasur parasysh nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive apo autoriteti publik edhe në përpunimin apo vendimin që merret në trajtimin e çdo rasti konkret. Personat që do të pretendonin se nga publikimi i të dhënave të deklaratës së pasurisë u është shkelur një e drejtë e caktuar kushtetuese apo ligjore, mund të ankohen në rrugë administrative ose gjyqësore, duke kërkuar me këtë rast jo vetëm rivendosjen e së drejtës së shkelur, por edhe shpërblimin e dëmit respektiv. Vetë ligji nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” e garanton një të drejtë të tillë (shih nenet 15 - 17 të këtij ligji).

7. Kërkuesi vë në diskutim edhe kushtetutshmërinë e nenit 22 të ligjit nr.9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në të cilin përcaktohet detyrimi i deklarimit të pasurisë edhe për pjesëtarët e familjes së subjektit deklarues, nëse ato kanë pasuri të ndarë dhe të regjistruar si të tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, si dhe të nenit 8 të këtij ligji, në të cilin kërkohet deklarimi i pasurisë së një kategorie të caktuar subjektsh për një periudhë prej dy ose katër vjetësh pas largimit të tyre nga funksioni.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se familja, në kuptimin e ngushtë, në kushte normale, përbëhet nga bashkëshortët dhe fëmijët. Në kuptim të gjerë, ajo përfshin edhe lidhjet e tjera familjare vertikale, horizontale, etj. Në rastin në gjykim, çështja thjeshtohet për shkak se vetë ligjvënësi e ka kufizuar konceptin e anëtarëve të familjes së subjektit deklarues që mbartin detyrimin e deklarimit të pasurisë në bazë të nenit 22 të ligjit nr.9049. Në paragrafin e parë të nenit 21 të këtij ligji deklarohet se: “Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore)”. Sigurisht që edhe në këto raste, në përputhje me nenin 34 të ligjit nr.9049, publiku ka të drejtë të njihet me përmbajtjen e deklarimeve të bëra. Ky rreth i kufizuar personash është i lidhur ngushtësisht edhe në interesa pasurore me subjektin deklarues. Prandaj kufizimi i së drejtës së tyre të jetës private në formën e deklarimit të pasurisë së ndarë dhe mundësia e publikimit të saj në funksion të transparencës dhe të kontrollit, është e drejtë dhe në proporcion me synimin që dëshërohet të arrihet. Ai është në përputhje me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës. Në të kundërt, mosbërja e këtyre deklarimeve dhe moslejimi i publikimit të tyre do të shtonte në mënyrë të konsiderueshme rrezikun e fshehjes apo të manipulimit të të dhënave mbi pasurinë e subjektit deklarues, duke zbehur kështu dukshëm zbatimin me efikasitet të këtij ligji në praktikë.

Mbi të njëjtat argumente vlerësohet i drejtë edhe detyrimi i deklarimit të pasurisë së subjekteve deklaruese për një periudhë dyvjeçare pas largimit nga funksioni. Madje, për një kategori të caktuar të tyre, në vartësi të detyrave të rëndësishme e me përgjegjësi të veçantë publike që kryejnë, ky detyrim është për një periudhë katërvjeçare. Kufizimi i jetës private në këtë formë për një periudhë relativisht të shkurtër pas largimit nga funksioni publik, është në vetë logjikën e ligjit nr.9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Ai i shërben edhe më mirë zbatimit në praktikë të këtij ligji, veçanërisht realizimit të transparencës së këtyre personave, shmangies së konfliktit të interesave dhe luftës kundër korrupsionit. Është mëse e qartë se ka ose mund të ketë lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet pasurisë, detyrimeve financiare apo angazhimeve në një biznes apo veprimtari tjetër të këtij individ, me funksionin apo detyrën zyrtare që ai ka kryer më parë. Prandaj edhe ky detyrim ligjor nuk ka karakter antikushtetues. Edhe këto deklarime të bëra për këtë periudhë mund të publikohen në përputhje me ligjin nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Në deklarimet e bëra mund të ketë edhe emra dhe të dhëna pasurore ose personale të personave të tretë apo familjarëve të tyre, të cilët nuk janë subjekte që mbartin detyrimin për

deklarim, por që janë të lidhur me këto subjekte në kuptim të nenit 2 pika 4 të ligjit nr.9049 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare dhe të disa nëpunësve publikë” (kanë “.... pasur ose kanë lidhje pasurore me personin që mbart detyrimin për deklarim”). Edhe këto të dhëna mund t’i jepen publikut. Por, në kuptim edhe të nenit 4 të ligjit nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, nuk mund të jepen emrat konkretë të këtyre personave, përderisa vetë ato nuk janë subjekte deklaruese sipas nenit 3 të ligjit nr.9049 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Aq më tepër që ato mund të mos jenë në dijeni për deklarin e bërë në emër të tyre, si dhe për saktësinë e këtij deklarimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Vendimi është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Industrisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore” që preken nga ndërtimi i linjës elektrike “Për lidhjen e nënstacionit elektrik 220/110 kv Rrashbull me sistemin”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: KESH sh.a., Tiranë.

Me anën e këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INDUSTRIE DHE ENERGJETIKËS
RRETHI DURRËS
KOMUNA RRASHBULL

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË LIDHJES SË NËNSTACIONIT
220/110 KV RRASHBULL ME SISTEMIN

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet : Tokë Bujqësore Arë

Nr.	Emri	Mbiemri	Nr. pasurisë	Sipërfaqja përgjithshme m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime
	Zaim	Hoxha	25/33	16	1 100	17 600	Nese paraqet dokumentin e pronësisë
2.	Avdi	Gashi	56/1	16	1 100	17 600	
3.	Asllan	Kosturi	55/1	100	1 100	110 000	
4.	Françesk	Vukaj	56/22	97	1 100	106 700	
5.	Hajredin	Nikoçi	56/24	98	1 100	107 800	
6.	Haki	Nikoçi	56/18	49	1 100	53 900	
7.	Gramoz	Beshtika	71/41 (71/12)	100	1 100	110 000	
8.	Isuf	Vela	56/45 (56/23)	81	1 100	89 100	
9.	Enkeleda dhe Entela	Shquti	78/20	49	1 100	53 900	
	Totali			606		666.600	

KËRKESË

Shtetasi Telha Tresa, lindur në Tiranë dhe banues në Vaqarr Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasit Asllan Hasan Tresa.

KËRKUES
Telha Tresa

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-eksponitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
15.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500

Doli nga shtypi më 22.11.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë